



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 418/6 prot.

Tiranë, më 26 . 09 . 2025

V E N D I M

Nr. 224 , datë 26 . 09 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 59, datë datë 06.03.2025³, të shtetasit R. S⁴ kundër Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës⁵, në të cilën pretendon diskriminimin të vajzës të mitur A. S, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës së z. S, në mes të tjerash parashtrohet se:
“...aktualisht jam në proces gjyqësor për zgjidhjen e martesës dhe pasojave të saj, me bashkëshorten S. S, me të cilën kam dy vajza të mitura (N. 12 vjeçe dhe A. 6 vjeçe) që prej datës 23.05.2022.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose shkurtesën Komisioneri.

³ Për efekt të fillimit të afateve procedurale, ankesa është plotësuar me datë 21.03.2025.

⁴ Përfaqësues i fëmijës së tij të mitur A. S.

⁵ Në vijim do t’i referohemi me akronimin ASHDMF ose shkurtesën Agjencia.

Paraqes këtë ankesë kundrejt Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, e cila ka dështuar të ushtrojë përgjegjësitë e saj ligjore në garantimin e të drejtave të fëmijës tim, A. S, e cila është e diagnostikuar me “Suspect Sindromë Çrregullim i Spektrit të Autizmit”. Pavarësisht kërkesave të mia të shumta, ky institucion ende nuk ka ndër marrë asnjë veprim...”

Z. S, ndër të tjera, citon se:

“1. ASHDMF ka detyrimin ligjor që të monitorojë mirëqenien e fëmijëve dhe të ndërhyjë në rastet kur një fëmijë nuk merr kujdesin e duhur nga prindi kujdestar. Në këtë rast, ASHDMF: Duhet të vlerësojë pasojat e neglizhencës së nënës për shëndetin dhe zhvillimin e A. Duhet të rekomandojë masa për të siguruar që fëmija të marrë trajtimet e nevojshme. Duhet të hartojë një raport mbi ndikimin e mungesës së kujdesit të duhur për A dhe të propozojë ndërhyrje të menjëhershme.

2. Ndikimi psikologjik dhe emocional i izolimit të A nga babai dhe motra e saj. Përveç neglizhencës në aspektin mjekësor dhe terapeutik, A është duke përjetuar izolim nga babai dhe motra e saj, i cili ka pasojat e thella në mirëqenien e saj emocionale dhe psikologjike:

a) Pasojat emocionale të izolimit nga babai Sipas ligjit dhe psikologjisë së zhvillimit, fëmijët kanë nevojë për të dy prindërit për të pasur një zhvillim të shëndetshëm emocional. Ndërprerja e kontaktit me babanë i shkakton A ndjenja ankthi, pasigurie dhe humbjeje, të cilat mund të kenë ndikim të përhershëm në zhvillimin e saj psikologjik. Izolimi nga babai përbën një formë të dhunës emocionale, pasi i mbron fëmijën të drejtën për të ndjerë siguri dhe përkrahje nga të dy prindërit. ASHDMF ka dështuar të ndërhyjë për të siguruar që vendimet gjyqësore për takimin e A me babanë të zbatohen.

b) Pasojat emocionale të izolimit nga motra N. S, motra e A, është një figurë e rëndësishme emocionale për të. Marrëdhëniet midis motrave janë thelbësore për mirëqenien e tyre psikologjike dhe ndihmojnë në ndërtimin e një lidhjeje të sigurt emocionale. Ndërprerja e kontaktit me motrën mund të krijojë ndjenja braktisjeje, vetmie dhe pasigurie tek A. • Izolimi nga motra e saj e ka bërë A më të ekspozuar ndaj ndikimeve të nënës, e cila ka shmangur terapitë dhe trajtimet e rekomanduara për të.

c) Roli i ASHDMF në këtë situatë ASHDMF ka për detyrë të:

Hartojë një raport të qartë mbi ndikimin e izolimit të A nga babai dhe motra e saj.

Rekomandojë masa për të siguruar që A të mos izolohet nga familja e saj. Ndërhyjë për të siguruar që vendimet gjyqësore për takimet e A me babanë dhe motrën të zbatohen në praktikë.

3. Pse ky vlerësim është thelbësor për të garantuar mbrojtjen dhe mirëqenien e A?

a) Për të konstatuar dhe provuar neglizhimin e A nga nena e saj. Një raport i detajuar nga ASHDMF do të tregonte se fëmija është lënë në mëshirën e një prindi që e ka neglizhuar atë dhe që institucionet nuk kanë ndërhyrë për të garantuar të drejtat e saj. ASHDMF ka dështuar të veprojë për të mbrojtur A, duke lejuar diskriminimin e saj për shkak të aftësisë së kufizuar.

b) Për të kërkuar masa konkrete për mbrojtjen e A. Raporti duhet të shërbejë si një bazë për të detyruar institucionet që të ndërmarrin masa konkrete për mbrojtjen e fëmijës. Ky vlerësim duhet të përfshijë propozime për veprime të menjëhershme, siç janë:

- Detyrimi i ASHDMF për të siguruar ndjekjen e trajtimeve mjekësore për A.
- Mbikëqyrja e S. S për të siguruar që ajo nuk e izolon më A.

4. Përfundim - Ndërmarrja e hapave për të siguruar që A të rikuperojë lidhjet e saj familjare me babanë dhe motrën. Kërkesa për një raport nga ASHDMF është një hap i rëndësishëm për të siguruar që diskriminimi dhe neglizhenca e Alanës të dokumentohen dhe që të ndërmerren masa për mbrojtjen e saj. Ky raport do të jetë provë e qartë që ASHDMF ka dështuar të përmbushë detyrimet e saj dhe se duhet të ndërmerren veprime urgjente për të mbrojtur mirëqenien e A. S.”

Subjekti ankues ka kërkuar, ndër të tjera, nga Komisioneri: “Konstatimin e diskriminimit të fëmijës A. S për shkak të aftësisë së kufizuar të saj, nga ana e ASHDMF për shkak të mosveprimit të Agjencisë, në garantimin e të drejtave të Alanës.

Agjencia të marrë masa urgjente për të siguruar ndërhyrjen dhe mbrojtjen e fëmijës në përputhje me ligjin. Agjencia të kryejë një vlerësim të plotë mbi situatën e A dhe të përgatisë një raport zyrtar mbi ndikimin e sjelljes neglizhuese të nënës dhe izolimit të A nga motra dhe babai”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a, të LMD, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të

njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 418/1 prot., datë 26.03.2025, ka kërkuar nga ASHDMF, informacionin dhe dokumentacionin si vijon:

- *“Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.*
- *Kopje të Rregullores së ASHDMF-së, nëse dispononi një të tillë.*
- *Kopje të praktikës në fjalë si dhe të komunikimit/korrespondencës shkresore me z.R. S, nëse dispononi një të tillë.*
- *Informacion lidhur me masat e ndërmarra nga ana e Agjencisë për zgjidhjen e problematikës së paraqitur nga i ati i fëmijës A. Si, z. R. S.*
- *Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.”*

2. Nëpërmjet shkresës me nr. 22/12 prot., datë 07.04.2025, ASHDMF, ka dërguar parashtrimet e saj, duke informuar ndër të tjera, Komisionerin se:

“...ASHDMF e ushtron funksionin e saj përmes mekanizmave në nivel vendor e qendror që janë Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF), struktura për koordinim dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimit të rasteve.

Bazuar në nenin 51, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, PMF në Bashki, kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.

Ligji ka përcaktuar qartësisht që menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nuk është kompetencë e ASHDMF, por e menaxherëve të rasteve, të cilët janë PMF në Bashki ose njësi administrative. Procesi i menaxhimit të rastit nga PMF, realizohet sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit të rastit e të menaxhimit

të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin të masave të mbrojtjes”.

Bazuar në këto përcaktime ligjore, në rastet kur ASHDMF konstaton apo vihet në dijeni të një problematike lidhur me fëmijë në nevojë mbrojtjeje, e referon rastin për verifikim dhe menaxhim pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor.

Përsa i përket ankesës së z. S, ASHDMF, është njohur me pretendimet e babait të vajzës A. S, për dhunë psikologjike, presion dhe neglizhencë ndaj vajzës që jeton me nënën, pasi prindërit e fëmijës janë në proces divorci.

Vajza është diagnostikuar me autizëm dhe ka një vendim gjykate për trajtimin e saj në qendër të specializuar, shërbim të cilin babai pretendon që vajza nuk e merr. Gjithashtu ai pretendon që nëna ka penguar fëmijën për t’u takuar me babain dhe me motrën e saj.

Menjëherë pas marrjes së ankesës, ASHDMF, e refroi rastin tek PMF në Bashkinë Vlorë, për të bërë një vlerësim të plotë të situatës familjare, shëndetësore dhe mirëqenies psiko-sociale të fëmijëve të familjes S.

Në komunikimet e vazhdueshme me PMF, jemi informuar që nëna fillimisht, nuk ka qenë bashkëpunuese. Nëpërmjet avokates së saj janë refuzuar takimet e drejtpërdrejta të nënës me PMF dhe mundësia e vizitës në familje.

Pas kësaj, ASHDMF, me qëllim për të siguruar mirëqenien e fëmijës, kërkoi nëpërmjet shkresës me nr. 22/3 prot., datë 24.02.2025, që vlerësimi dhe vizita në familje të realizohej në bashkëpunim me policinë, bazuar në nenin 62, të të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Në vijim, PMF, në Bashkinë Vlorë na informoi nëpërmjet shkresës me nr. 4074, datë 13.03.2025, që është bërë i mundur takimi me nënën e fëmijës në Zyrën e PMF, në ambientet e Bashkisë Vlorë. Gjatë takimit është dakordësuar që të realizohet vizita në familje dhe të bëhet vlerësimi i plotë i fëmijës A. S. Gjatë takimit në Zyrë, është mbajtur dhe procesverbali përkatës nga të pranishmit.

Ndër të tjera, gjatë këtij takimi nëna është shprehur që nuk është dakord me pretendimet e babait të fëmijës për dhunë psikologjike, presion apo neglizhencë të saj ndaj vajzës A. Sipas saj këto janë veprime të qëllimshme të babait të vajzës që synojnë denigrimin e figurës së saj. Nëna bën me dije gjithashtu se babai nuk ka lejuar nënën që prej 18 muajsh të takojë vajzën tjetër N. S, që jeton me babain dhe bashkëjetuesen e tij.

Më pas, me shkresën me nr. 4446 prot., datë 20.03.2025, jemi informuar që është realizuar vizita në familje dhe vlerësimi i rastit të fëmijës A. S. Vizita është realizuar në banesën e prindërve të znj. Si, ku jetojnë nëna dhe dy gjyshërit të vajzës A. S. Sipas vlerësimit, vihet re që nëna dhe vajza kanë një atashim shumë të mirë. Gjithashtu edhe me gjyshen fëmija ka një marrëdhënie shumë të mirë.

Fëmija i mitur nuk ka asnjë shenjë që të tregojë që është i neglizhuar apo i keqtrajtuar. Vajza është e qeshur dhe ndërvepruese me specialistët dhe me familjarët. Fëmija duket e përshtatur mjaft mirë në familje, ndërvepron pozitivisht me nënën dhe me gjyshen që janë prezentë. Fëmija është i veshur mirë dhe në mënyrë të rregullt e të përshtatshme, të pastër, banesa ofron kushte për mirërritjen e fëmijës A. S.

Nëna kujdeset për fëmijën maksimalisht dhe kalon kohë aktive me fëmijën, në aktivitete argëtuese dhe ndërvepruese me fëmijën. Fëmija frekuenton kopshtin dhe atje është pjesë e aktiviteteve që organizohen në kopsht. Fëmija trajtohet me shërbim logopedik dhe terapi zhvillimi. Nëna është e punësuar dhe siguron të ardhura të mjaftueshme për të siguruar kushte jetese të mira për fëmijën. Gjatë vizitës në familje është mbajtur një procesverbal nga të pranishmit.

...sikurse është sqaruar më sipër, me gjithë sfidat që PMF e Bashkisë Vlorë ka hasur gjatë punës për të bërë vlerësimin e rastit, me insistimin dhe ndërhyrjen e ASHDMF-së, është bërë e mundur që të realizohet vizita në familje dhe vlerësimi i rastit.

Përsa i përket pretendimeve të z. S lidhur me pengesën për realizimin e takimeve të tij me fëmijën A. S, theksojmë që, për zbatimin e vendimeve të gjykatës lidhur me takimet me fëmijët, z. S duhet t'i drejtohet Shërbimit Përmbarimor, pasi kjo çështje është jashtë kompetencës së punës së ASHDMF-së.

Përsa i përket ecurisë së trajtimit të rastit, ASHDMF, ka kërkuar nga NJMF e Bashkisë Vlorë, të vijojë monitorimin dhe vizitat në familje të fëmijës A. S, për t'u siguruar që ajo merr trajtimin e duhur shëndetësor dhe ka përkujdesjen e duhur për mirëqenie fizike dhe emocionale.”

3. Në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe procesit të drejtë administrativ, prashtrimet dhe dokumentacioni i depozituar pranë Komisionerit nga ASHDMF, i është përcjellë për njohje, subjektit ankues, nëpërmjet e-mailit datë 16.04.2025.
4. Pas njohjes me sa më sipër, pala ankuese nëpërmjet e-mailit datë 17.04.2025, ka depozituar qëndrimin e saj duke bashkëlidhur dokumenta në cilësi prove. Dokumentacioni respektiv është pjesë e dosjes së z. S pranë KMD-së dhe do të analizohet gjatë arsyetimit të këtij vendimi.
5. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 418/3 prot., datë 16.06.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Palëve iu është bërë e ditur, se gjatë seancës kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësojnë se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve e rrethanave të çështjes.

6. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 30.06.2025, pranë Zyrës së Komisionerit, në prani të palëve në proces.

Pala ankuese u përfaqësua në këtë seancë⁶ nga Av. T. N dhe Av. E. B.

Pala kundër së cilës është depozituar ankesa, ASHDMF, nëpërmjet Autorizimit me nr. 22/23 prot., datë 25.06.2025, u përfaqësua nga znj. A. B, me detyrë specialiste dhe znj. M. X, me detyrë juriste pranë këtij institucioni.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Secila nga palët shprehu qëndrimin dhe argumentat e saj respektive lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, të cilat në thelb janë të njëjta dhe në përthje me ato të paraqitura shkresërisht pranë KMD-së. (Pasqyruar këto në procesverbalin e mbajtur gjatë seancës, si dhe regjistrimin audio të saj⁷).

Përfaqësuesit e ASHDMF-së, gjatë seancës depozituan në cilësi prove, shkresën me nr. 22/16 prot., datë 23.04.2025, e cila është konsideruar dhe analizuar gjatë arsyetimit të vendimit, bashkarisht dhe në harmoni me provat e tjera të depozituara gjatë procesit të hetimit.

7. Pas seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 22/24 prot., datë 10.07.2025, ASHDMF, ka depozituar pranë KMD-së, një relacion përmbledhës mbi procedurat e ndjekura nga ky institucion lidhur me rastin e fëmijës A. S, si dhe dokumentacionin përkatës.

Parashtrimet e ASHDMF-së në këtë relacion përmbledhës, paraqiten si më poshtë citojmë:

“Me marrjen e ankesës nga z. R. S, ASHDMF ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore që i ngarkon ligji. Më poshtë është listuar komunikimi shkresor që ASHDMF ka mbajtur me strukturat e mbrojtjes së fëmijës në Bashkinë Vlorë, të cilat u sqaruan nga pala e ASHDMF e përfaqësuar nga dy specialiste të ASHDMF, në seancën dëgjimore, datë 30.06.2025, pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Më poshtë gjeni informacionin, hapat e ndjekura dhe procedurat e ndërrmarra nga ASHDMF. Informacioni është i strukturuar në dy pjesë:

⁶ Me deklaram të palës ankuese para KMD-së.

⁷ Prova të cilat janë depozituar në cilësi prove, në dosjen e palës ankuese, pranë KMD-së.

Pjesa e parë : Komunikimi shkresor me strukturat e mbrojtjes së fëmijës në Bashkinë Vlorë, me babain e fëmijës dhe institucionet e tjera të pavarura.

- ✓ Në datë 03.12.2024, z.R. S me anë të shkresës nr. 176, ka referuar rastin e fëmijës së tij A. S pranë ASHDMF për ndërhyrje të menjëhershme lidhur me dhunën psikologjike dhe neglizhencën e nënës së fëmijës, znj. S. S ndaj fëmijës A. S.
- ✓ ASHDMF me anë të shkresës nr. 276/1, datë 10.12.2024, ka dërguar kërkesë për informacion dhe ndjekje rasti, drejtuar znj. S. M, PMF, Bashkia Vlorë, pas referimit të rastit nga z. R. S, lidhur me marrjen e masave dhe monitorimin e situatës së fëmijës A. S.
- ✓ Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social, Bashkia Vlorë, me anë të shkresës nr. 19935/1, datë 30.12.2024 ka dërguar informacion tek ASHDMF duke dërguar procesverbalet e mbajtura gjatë takimeve të nënës me fëmijën N.S, takimet sipas kalendarit të përcaktuar nga gjykata.
- ✓ Duke qenë se informacioni i dërguar nga PMF nuk përmbante vlerësim të plotë të rastit në datë 08.01.2025 ASHDMF nëpërmjet e-mail ka kërkuar raportin e përmbledhur zyrtar për rastin S. drejtuar PMF znj. S. M.
- ✓ Në datë 23.01.2025 Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social, Bashkia Vlorë, me anë të shkresës nr. 1109, ka dërguar informacion mbi rastin A. S ku përcaktohet se takimet janë kryer sipas vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe stafi i Shërbimit Social ka qenë prezent në të gjithë takimet ku në procesverbalet e mbajtura ka konstatuar të gjithë ecurinë e takimeve.
- ✓ ASHDMF ka njoftuar z. R. S me shkresën nr. 276/4, datë 23.01.2025 për përcjelljen e dosjes me informacion mbi rastin dhe procesverbalet e mbajtura nga PMF e Bashkisë Vlorë gjatë takimeve me vajzën dhe nënën.
- ✓ Z. R. S ka depozituar kërkesën drejtuar ASHDMF me nr. 22/1, datë 29.01.2025 për vlerësim të situatës së fëmijës A. S që jeton me znj. S. S.
- ✓ ASHDMF me anë të shkresës nr. 22/3, datë 24.02.2025, ka bërë kërkesë për vlerësim të situatës së fëmijës A.S drejt PMF Bashkia Vlorë, pas informimit se nëna e fëmijës bën rezistencë dhe nuk ka qenë bashkëpunuese për realizimin e vlerësimit në familje të vajzës së mitur A. S nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës. ASHDMF në shkresën e saj cilësoi nenin 62, të ligjit nr. 17/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” - “Mbrojtja e fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar” ku theksohet se: “Strukturat e mbrojtjes së fëmijës janë përgjegjëse për të verifikuar dhe trajtuar çdo rast të identifikuar apo raportuar të fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe dhunuar dhe kanë të drejtë të kenë akses në banesën e prindit apo të personit fizik, të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijës së identifikuar apo të raportuar si viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Kur, në bazë të rrethanave dhe fakteve është e nevojshme, strukturat e mbrojtjes së fëmijës kërkojnë mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit”.
- ✓ Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social me anë të shkresës nr. 4074, datë 13.03.2025, drejt ASHDMF, paraqet informacionin për realizimin e vizitës në familje për të miturën A. S, Bashkëlidhur procesverbali i mbajtur.

- ✓ Më datë 05.03.2025 institucioni i Avokatit të Popullit me anë të shkresës nr. K5/R5-2, kërkon informacion nga ASHDMF për rastin A. S pas paraqitjes së ankesës së shtetasit R. S, ku janë shtjelluar të gjithë rrethanat e rastit.
- ✓ ASHDMF ka përgatitur kthim përgjigje drejtuar Avokatit të Popullit me anë të shkresës nr. 22/6, datë 18.03.2025, lidhur me rastin e fëmijës A. S ku është përmbledhur rasti dhe informacioni i mbledhur nga PMF, ku tregohet që nëna nuk ka qenë bashkëpunuese dhe së bashku me avokaten e saj kanë refuzuar takimet e drejtpërdrejta të PMF me nënën dhe vajzën e mitur por është dakordësuar realizimi i vizitës në familje është bërë vlersimi i rastit të fëmijës A. S.
- ✓ Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social me anë të shkresës nr. 4446, datë 20.03.2025 ka dërguar informacion drejt ASHDMF, rreth rastit ku informon që është realizuar takim në banesën e prindërve të S. S. PMF ka mbajtur procesverbal gjatë takimit. Nga informacioni i përcjellë nga PMF dhe Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social, cilësohet se kushtet e banesës janë të përshtatshme ku e mitura ka dhomën e saj dhe sendet e nevojshme si dhe atashimi i mirë që vajza ka me nënën dhe me gjyshen. Bashkëlidhur është dërguar dhe procesverbali i takimit.
- ✓ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Hetimit Administrativ, me anë të shkresës nr. 418/1, datë 26.03.2025, ka dërguar ASHDMF njoftim dhe kërkesë për informacion, lidhur me ankesën e z. R. S kundrejt ASHDMF ku pretendon diskriminimin e vajzës së mitur A. S për shkak të aftësisë së kufizuar.
- ✓ Më datë 27.03.2025 ASHDMF me anë të shkresës nr. 22/9 ka vënë në dijeni Komisionerin e Avokatit të Popullit për procedurat e ndjekura nga ASHDMF për ndjekjen e rastit.
- ✓ Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social me anë të shkresës nr. 5088, datë 02.04.2025, ka dërguar ASHDMF vlerësimin të miturës A. S, (bashkëlidhur formulari i vlerësimit).
- ✓ ASHDMF me anë të shkresës nr. 22/12, datë 07.04.2025 i ka kthyer përgjigje Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Hetimit Administrativ, kthim përgjigje për rastin e fëmijës A. S ku bëhet shpjegimi i detajuar i rastit dhe roli i ASHDMF.
- ✓ ASHDMF i ka kthyer përgjigje Komisionerit nga Avokati i Popullit, me anë të shkresës nr. 22/13, datë 08.04.2025, ku ASHDMF për rastin e A. S dhe ka vënë në dispozicion formularin për vlerësimin dhe analizën rrezikut të rastit dhe raportit të ekspertit mjeko-ligjor.
- ✓ ASHDMF i ka kërkuar PMF Vlorë me anë të shkresës nr. 22/16, datë 28.04.2025 informacion mbi trajtimin e fëmijës A.S dhe **rivlerësim** i rastit të fëmijës A. S
- ✓ Meqë informacioni i kërkuar nga ASHDMF nuk po dërgohej në afat nga Bashkia Vlorë, më datë 29.05.2025 me shkresën nr. 22/18, ASHDMF i është drejtuar PMF Bashkia Vlorë dhe drejtoreshës znj. I. S për vlerësim të situatës së fëmijës A. S.
- ✓ Duke hasur vonesa për kthimin e përgjigjes nga drejtoresha znj. I. S lidhur me shkresën e datës 28.04.2024, i jemi drejtuar për herë të dytë me shkresën nr. 22/15, datë 22.04.2025; nr. 22/17, datë 23.04.2025; kërkesa për marrjen e masave për monitorimin dhe evidentimin e situatës së fëmijës A.S drejtuar ASHDMF.
- ✓ Lidhur me kërkesat e z. R. S të datave 17.04.2025, 22.04.2025, 23.04.2025, 02.06.2025, kthimi i përgjigjes ishte i pamundur për shkak të vonesave nga Bashkia Vlorë. Sqarojmë që gjatë kësaj

periudhe ASHDMF ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me PMF dhe drejtoreshën për kthimin e përgjigjes. Arsyetimi nga Bashkia Vlorë ishte që ata dhe Drejtoria e Sherbimit social kanë përgatitur shkresën e kthim përgjigjes, por ishte nënkryetarja e Bashkisë znj. I. T, që e kthente shkresën për arsye formatimi apo ndonjë gabim drejtshrimor.

- ✓ Bazuar në situatën e sipërcituar, me datë 17.06.2025, ASHDMF, ka njoftuar për fillimin e kontrollit të cilësisë së punës Për punonjësin për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) në Bashkinë Vlorë dhe në datat 23-25.06.2025 është kryer kontrolli.
- ✓ Më në fund Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social dërgoi përgjigje me anë të shkresës nr. 22/21, datë 19.06.2025, për informacion lidhur me kërkesat e ASHDMF bazuar në kërkesat e babait të fëmijës. Sipas përgjigjes nga PMF Vlorë, fëmija është në kushte të mira dhe tregohet qartë që vajza jeton në atë banesë, është cilësuar vendbanimi dhe adresa në të cilën vajza jeton. Urdhëri i mbrojtjes është rrëzuar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin 6688, datë 24.09.2024, vajza ndjek kopshtin nr. 13 me frekuentim të rregullt dhe ka progres në ndërveprimin me bashkëmoshatarët. Bashkëlidhur gjendet Plani Edukativ Individual (PEI) që trajton fëmijën në kopësht.
- ✓ Përgjigjen e PMF, ASHDMF ia vuri në dispozicion babait të fëmijës z. R. S me anë të shkresës nr. 22/22, datë 20.06.2025, ku i janë dhënë sqarimet si më poshtë :
 - NJMF konfirmon që vajza jeton në banesën që nëna ka dhënë si adresë;
 - Urdhri i mbrojtjes ndaj gjyshërve të vajzës është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit me vendim 6688, datë 24.09.2024;
 - NJMF ka përcjellë informacionin e siguruar nga Kopshti, ku fëmija merr shërbim të specializuar së bashku me raportet e trajtimit të fëmijës, ku bashkëlidhur gjendet procesverbali i nënshkruar nga një ekip multidisiplinar profesionistesh që trajtojnë fëmijën përmes Planit Edukativ Individual, ku përfshihet psikologu, logopedi, mësuesi kujdestar dhe mësuesi ndihmës.

Pjesa e dytë : Procedura e kontrollit të zhvilluar nga ASHDMF tek strukturat e mbrojtjes së fëmijës në Bashkinë Vlorë në datë, 23.06.2025-24.06.2025

Mbështetur në ligjin nr. 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, neni 41, pika 3/ c dhe Udhëzimin nr. 767 datë 28.12.2023 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për Miratimin e Metodologjisë së Kontrollit të Cilësisë së Punës të Strukturave të Mbrojtjes së Fëmijës në Nivel Vendor”, në datë, 23.06.2025-24.06.2025 me Urdhër nr. 86/1 datë 18.06.2025, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, realizoi kontrollin e cilësisë së punës së strukturës për mbrojtjen e fëmijës në Bashkinë Vlorë.

Objekti i Kontrollit ishte vlerësimi i zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi për çështjet e mbrojtjes së fëmijës nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe aktet ligjore në zbatim të tij, gjatë menaxhimit të rastit të fëmijës A.S të z. R. S.”

Në përfundim të monitorimit ASHDMF ka përgatitur raportin e kontrollit dhe ka përcaktuar rekomandimet me afatet për zbatim për strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe Bashkinë Vlorë të cilat do të citohen në vijim të këtij vendimi.

8. Nëpërmjet e-mailit datë 14.07.2025, relacioni sa më sipër i depozituar pranë KMD-së nga ASHDMF, i është përcjelle për njohje palës ankuese.
9. Nëpërmjet e-mailit datë 15.07.2025, pala ankuese ka depozituar qëndrimin dhe kontestimet e saj lidhur përmbajtjen e relacionit të datës 10.07.2025, të ASHDMF-së, të cilat janë vlerësuar dhe analizuar nga Komisioneri, gjatë arsyetimit të vendimit, bashkërisht me prapësimet e dokumentacionin e depozituar në dosje përgjatë gjithë procesit të hetimit të kësaj çështjeje.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çësht

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të fëmijës A. S nga ana e ASHDMF-së.

Në bazë të informacionit dhe akteve të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, subjekti ankues R. S në ankesën drejtuar Komisionerit ka pretenduar se:

ASHDMF nuk i është përgjigjur kërkesave të tij për ndërhyrje në mbrojtje të vajzës së mitur A. S, pavarësisht ankesave, dokumentave, vendimeve gjyqësore, raporteve mjekësore që evidentojnë nevojën për trajtim e mbështetje ndaj vajzës së mitur

Agjencia ka neglizhuar detyrimet e saj ligjore, mosveprim i cili ka penguar trajtimet mjekësore të specializuara ndaj fëmijës A. S dhe izolimin e saj nga babai dhe motra.

Nga aktet e paraqitura, rezulton se:

Ankuesi R. S ka lidhur martesë me shtetasen S. S, në datën 12.10.2012, pranë Bashkisë Vlorë.

Nga martesë mes tyre kanë lindur dy vajza: N. S e datëlindjes 04.01.2013 dhe A. S e datëlindjes 05.11.2018.

Më datë 23.05.2022, ankuesi R. S me kërkesë-padi drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka kërkuar zgjidhjen e martesës me bashkëshorten S. S, lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim dhe dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Ndërkohë në muajin tetor 2022, vajza e mitur A. S është diagnostikuar me “Suspect Sindromë Çrregullim i Spektrit të Autizmit”.

Për një ekzaminim më të thelluar e profesional të fëmijës A. S, ankuesi ka kontaktuar dhe rezervuar një ekzaminim mjekësor në Fondacionin Fëmijët Shqiptar, por, meqenëse mes bashkëshortëve (tashmë në proces divorci) nuk ka pasur dakordësi, atëherë ankuesi i është drejtuar Gjykatës, për marrjen e masës së përkohshme.

Me Vendimin nr. 631 Regj. Themeltar, datë 12.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur:

- *“Pranimin e kërkesës së paditësit R. S.*
- *Marrjen e masës së përkohshme duke lejuar paditësin R. S të shoqërojë në datën 14.12.2022, fëmijën e mitur A. S, të datëlindjes 05.11.2018, në Fondacionin Fëmijët Shqiptarë, Tiranë, me qëllim kryerjen e ekzaminimeve mjekësore, sipas përcaktimeve në prenotimin e këtyre ekzaminimeve në datën 06.12.2022.*
- *Paditësi do të marrë fëmijën nga e paditura në orën 06:30, të datës 14.12.2022, në banesën ku banon e paditura dhe fëmija i mitur, dhe do ta kthejë përsëri fëmijën e mitur në të njëjtin vend, në mbrëmjen e datës 14.12.2022, në përfundim të ekzaminimeve dhe të udhëtimit.*
- *Lejohet e paditura S. S, nëse e vlerëson, të jetë prezent gjatë kryerjes së këtyre ekzaminimeve.*
- *Kundër këtij vendimi nuk parashikohet e drejta e ankimit.”*

Rezulton se ankuesi e ka realizuar ekzaminimin e fëmijës A.S në datën e caktuar pranë Fondacionit Fëmijët Shqiptarë, në Tiranë, ku është bërë diagnostikimi, si dhe është dhënë edhe trajtimi përkatës, i cili përfshin:

- Program për prindin;
- Program edukativ individual për fëmijën;
- Program orientues për punën në kopsht.

Sipas ankuesit ky program i është vënë në dispozicion edhe nënës së fëmijës S. S, e cila këtë program nuk ia ka vënë në dispozicion Kopshtit Nr. 15, Vlorë, që frekuentohej nga vajza e mitur A. S.

Sipas ankuesit, vajza e mitur nuk ka marrë trajtimin e duhur në vijimësi, pasi:

- Takimi i planifikuar nga Fondacioni Fëmijët Shqiptarë, i vajzës A. S me mjek psikiatër me datë 24.05.2023 nuk u krye për shkak të refuzimit të bashkëshortes (me të cilën është në proces gjyqësor për zgjidhje martesë).
- Sipas ankuesit, vajzës së mitur i janë ndërprerë dhe terapitë e logopedisë (terapi që në vetvete janë të pamjaftueshme) dhe se ka dy vite që nuk është realizuar asnjë kontroll mjekësor në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese të Fëmijëve, edhe pse nga kjo e fundit, me shkresën me nr. 66/4 prot., datë 02.10.2024 është evidentuar nevoja e një rikontrolli mjekësor.
- Meqenëse fëmija i mitur A. S mbahet për rritje dhe edukim nga bashkëshortja e ankuesit, ndërsa vajza e madhe, nga ky i fundit, dhe, duke mos pasur mirëkuptimin e bashkëpunimin

minimal, për trajtimin dhe kontrollin mjekësor të fëmijës A. S, ankuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për marrjen e masës së përkohshme.

- Kjo Gjykatë me vendimin nr. 631, datë 07.10.2024, ka vendosur:
- *“Pranimin e kërkesës.*
- *Marrjen e masës së përkohshme për të detyruar palët ndërgjyqëse, përkatësisht palën paditëse R. S dhe të paditurën S. S, për të shoqëruar fëmijën e mitur A. S, pranë Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese të Fëmijëve në Tiranë, në datën 29.10.2024, ora 11:00, me qëllim kryerjen e vizitave mjekësore.*
- *Shpenzimet në lidhje me kërkesën sic janë kryer.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet ankim i vecantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm...”*

Rezulton se urdhërimi i Gjykatës për vizitën mjekësore për fëmijën e mitur A. S nuk është zbatuar, për shkak të mungesës së vullnetit të bashkëshortes së ankuesit.

Për këtë shkak, ankuesi i është drejtuar rishtas Gjykatës për marrjen e masës së përkohshme, e cila, me vendimin e datës 07.10.2024, ka vendosur:

- *“Pranimin e kërkesës.*
- *Marrjen e masës së përkohshme për të detyruar palët ndërgjyqëse, përkatësisht palën paditëse R. Si dhe të paditurën S. S, për të shoqëruar fëmijën e mitur A. S, pranë Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilitueses të Fëmijëve në Tiranë, në datën 11.11.2024, ora 11:00, me qëllim kryerjen e vizitave mjekësore.*
- *Shpenzimet në lidhje me kërkesën sic janë kryer.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet ankim i vecantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm...”*

Gjatë procesit të divorcit ankuesi dhe bashkëshortja e tij, kanë vënë në lëvizje të vazhdueshme Gjykatën me kërkesa të ndryshme.

Kështu, me vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 14/30-2024-403, datë 24.01.2024, është vendosur:

- *“Ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 724, datë 16.11.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*
- *Refuzimin e vërtetimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësin R. S.*
- *Vërtetimin e urdhrit të mbrojtjes për fëmijën e mitur N. S duke vijuar masat e urdhrit të mbrojtjes në këtë ndryshim.*
- *Lejimin e takimit të fëmijës N. S dhe S. S, të shtunën e dytë dhe të katërt të cdo muaji nga ora 11:00-13:00. Takimi të zhvillohet në prezencë të punonjësit social të njësisë së Shërbimit Social pranë Bashkisë Vlorë,*
- *Lënien në fuqi për pjesën tjetër të tij...”*

Me vendimin nr. 80, datë 03.07.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është vendosur lëshim i urdhrit të mbrojtjes në favor të paditësit R. S dhe dy vajzave të tij, kundrejt gjyshërve nga ana e nënës dhe dajës së vajzave.

Ndërkohë që, kjo Gjykatë i ka dhënë fund procesit, për shkallën e parë, lidhur me çështjen e zgjidhjes së martesës mes ankuesit dhe shtetases S. S, ku me vendimin nr. 544, datë 04.11.2024, ndër të tjera, ka vendosur:

- *Zgjidhjen e martesës mes palëve.*
- *Lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve (dy vajzave) ankuesit, duke ushtruar të dy prindërit përgjegjësinë prindërore.*
- *Të drejtën e takimit të nënës me fëmijët sipas ditëve dhe orareve të përcaktuara, si dhe detyrimin e pagesës për pensionin ushqimor mujor në favor të dy vajzave të mitura.*
- *Për këto pjesë Gjykata ka përcaktuar dhënien e vendimit për ekzekutim të përkohshëm.*

Deri në shyrtimin e kësaj ankese në KMD, nuk rezulton të jetë zbatuar urdhërimi i Gjykatës për ekzekutim të përkohshëm.

Me shkresën e datës 15.10.2024, ankuesi ka bërë kërkesë për monitorim dhe ndërhyrje lidhur me mirëqenien e fëmijës së mitur A. S, drejtuar Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, pranë Bashkisë Vlorë, përmes së cilës kërkon:

“Sikurse jeni në dijeni, ekziston një vendim gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që më jep të drejtën për të takuar dhe për të pasur informacion për fëmijën tim. Megjithatë, nëna e A, znj. S. S, nuk po e zbaton këtë vendim dhe po pengon marrëdhëniet e mia me vajzën. Përveç kësaj, nuk më informon për shëndetin apo për mirëqenien e saj, sic parashikohet nga Kodi i Familjes dhe vendimi i Gjykatës.

Së fundmi, kam marrë informacion nga Kopshti nr. 15, se A nuk po e frekuntton më atë. I jam drejtuar dhe disa kopshteve të tjerë, por nuk rezulton e regjistruar. Kjo situatë më ka shkaktuar shqetësim të madh për mirëqenien e saj.

Në përputhje me ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, ju kërkoj që të ndërhyjni menjëherë për të kryer monitorime të situatës, për të hetuar mosregjistrimin dhe mungesën e frekuentimit të kopshtit nga A, dhe për të siguruar që ajo të përfitojë shërbimet e duhura të arsimit parashkollor.

Nëse A. është regjistruar në një kopsht tjetër, kërkoj që të më informoni menjëherë për emrin e këtij institucioni...”

Kjo e fundit, me shkresën me nr. 16665/1 prot., datë 21.01.2025, i është përgjigjur:

“Ju informojmë se është kontaktuar telefonikisht në datën 26.11.2024, nëna e të miturës A. S, për të realizuar vlerësim dhe monitorim. Kjo e fundit ka kërkuar t’i drejtohem i me shkresë zyrtare. Nga

Shërbimi Social është dërguar shkresë zyrtare me nr. 20160 prot., datë 13.12.2024, ku është vendosur data 18.12.2024 për të realizuar vlerësimin socio-ekonomik. Nëna e të miturës nuk ka bashkëpunuar me Shërbimin Social për realizimin e këtij vlerësimi. Në këto kushte, nuk është bërë i mundur vlerësimi socio-ekonomik.”

Për shkak të problematikave të mësipërme lidhur kryesisht me pengesat në mostrajtimin e fëmijës së mitur A. S, me terapi e shërbim të specializuar mjekësor, ankesa e z. R. S, e datës 03.11.2024, i është drejtuar ASHDMF-së, ku ka shpjeguar në mënyrë të hollësishme e të detajuar situatën e kronologjinë në lidhje me situatën e fëmijës A. S, diagnostikuar me S. Autizëm, dhe ka kërkuar nga ASHDMF-ja:

- *“Inspektim të kushteve aktuale të jetesës së A. për të vlerësuar sigurinë dhe mbrojtjen e saj nga dhuna dhe neglizhenca.*
- *Oranizimi i takimeve të rregullta dhe të mbikëqyrura mes meje, vajzës dhe motrës së saj, N.*
- *Vlerësim psikologjik dhe social për të përcaktuar ndikimet negative të izolimit dhe kushteve aktuale të saj.*
- *Zbatimi i vendimeve gjyqësore, duke detyruar S. S të respektojë të drejtat e fëmijës dhe të referojë moszbatimin në organet kompetente.*
- *Referim i rastit si dhunë psikologjike dhe nisjen e procedurave për ndjekje ligjore ndaj S. S për neglizhencë ndaj fëmijës.*
- *Hartimi i një plani mbrojtjeje për Alanën, përfshirë trajtime psikologjike dhe sociale që garantojnë zhvillimin e saj të shëndetshëm.*
- *Sigurimi i ndjekjes së terapive të rekomanduara mjekësore dhe rehabilituese.*
- *Koordinimin me strukturat lokale për monitorimin dhe raportimin e vazhdueshëm të situatës së A.*
- *Trajtimi me përparësi i çështjes, duke parandaluar dëmet e pariparueshme ndaj vajzës.*
- *Kërkoj që kjo çështje të trajtohet me përparësi të lartë, duke pasur në konsideratë dëmet e pariparueshme që mund të shkaktohen ndaj vajzës së mitur nëse situatë aktuale nuk trajtohet me seriozitetin dhe urgjencën e duhur, si pasojë e neglizhencës dhe formave të ndryshme të dhunës psikologjike ndaj saj.”*

Ankuesi ka vënë në dispozicion të ASHDMF-së, 22 (njëzet e dy) prova shkresore (vendime gjyqësore, dokumente mjekësore, shkresa zyrtare lidhur me çështjen, etj).

Në përgjigje të ankesës së z. R. S, ASHDMF, ka vijuar me procedurat përkatëse, me një seri shkresash e komunikimesh zyrtare me Drejtorinë e Shërbimit Social, pranë Bashkisë Vlorë (të përshkruara sipas kronologjisë në parashtrimet e ASHDMF-së, e të pasqyruara më sipër në këtë vendim).

Në përfundim të procedurës, ASHDMF, ka zhvilluar kontroll në datën 23.06.2025, deri në datën 24.06.2025, në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Vlorë, në lidhje me rastin e fëmijës së mitur A. S, dhe ka dalë me rekomandimet përkatëse, si më poshtë citohen:

- “PMF-ja të sigurojë plotësimin e të gjithë formularëve të përcaktuar në nenin 17, të VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij” për dy dosjet e rastit të dy fëmijëve A. S dhe N. S. PMF të dokumentojë në dosjen personale të gjitha të dhënat veprimet e marra, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë procesit të menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë, duke përfshirë edhe dokumentacionin origjinal kur ky i fundit është i disponueshëm. Të respektohen afatet ligjore për plotësimin e formularëve. Procedurat për menaxhimin e rastit duhet të paraqiten të personalizuar për çdo fëmijë.

Niveli i rëndësisë: i lartë

Periudha e zbatimit: Brenda 6 muajve

- PMF të krijojë dosje të individualizuar për rastin A. S. Është e nevojshme të bëhet rivlerësim i thelluar i rastit duke vlerësuar të gjithë elementët e rrezikut, intervistimin e të dy prindërve.

Niveli i rëndësisë: i lartë

Periudha e zbatimit: Brenda 6 muajve

- PMF dhe shërbimi social shtetëror në Bashkinë Vlorë të realizojë rivlerësimin e rastit N. S, duke realizuar vizitë në familje, intervista me fëmijë dhe të dy prindërit, takimi GTN për rastin, rishikimi i PIM dhe monitorimi periodik.

Niveli i rëndësisë: i lartë

Periudha e zbatimit: Brenda 6 muajve

- PMF të vlerësojë nevojën për hartimin e Planit Individual të mbrojtjes (PIM) për fëmijën me Aftësi të Kufizuar A. S më përfshirjen e të dy prindërve, të specialistëve të zhvillimit të fëmijës, mësues ndihmës, specialist logoped, mjek i specializuar, bazuar në nevojat dhe vlerësimet e specialistëve.

Niveli i rëndësisë: i lartë

Periudha e zbatimit: Brenda 3 muajve

- PMF të bashkëpunojë me prindin (nënë e fëmijës) A. S për sigurimin e informacionit të faktuar dhe dokumentuar për shërbimet rehabilituese dhe integruese mbështetëse dhe terapi zhvillimi (logopedist) dhe informimin e babait të fëmijës për këto shërbime.

Niveli i rëndësisë: i lartë
muajve

Periudha e zbatimit: Brenda 2

- PMF të qartësohet dhe të sigurohet për trajtimin e fëmijës A. S me shërbim të specializuar nga mjeku logopedist dhe terapia e zhvillimit për periudhën e verës që fëmija nuk frekuenton kopshtin.

Niveli i rëndësisë: i lartë

Periudha e zbatimit: Brenda 3 muajve

- *PMF në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës dhe Shërbimin social në Bashki të planifikojë, hartojë dhe dokumentojë plan ndërhyrje të punës me prindërit e fëmijës A. S dhe planifikimi i ndërhyrjeve me plane trajnimi për prindërimin pozitiv.*

Niveli i rëndësisë: i lartë

Periudha e zbatimit: Brenda 6 muajve

- *Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social në Bashki, të marrin masa për plotësimin e Standartit ligjor dhe emërimin e një PMF për çdo 3000 fëmijë.*

Niveli i rëndësisë: i ulët

Periudha e zbatimit: Brenda 1 viti

- *Kryetari /nënkryetari i Bashkisë Vlorë të miratojë shkresat dhe informacionet e përgatitura nga Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Vlorë për kthim përgjigje drejtuar institucionit të ASHDMF brenda afateve ligjore (10 ditë pune) .*

Niveli i rëndësisë: i lartë

Periudha e zbatimit: Brenda 2 muajve.”

Siç është përshkruar në këtë vendim, rasti i fëmijës A. S, paraqitet veçanërisht i ndjeshëm sa i takon nevojës për trajtim të specializuar, periodik e konstant të saj, lidhur me diagnozën e çrregullimit të spektrit autik.

Që nga viti 2022, kur fëmija A. S është diagnostikuar e në vijimësi, trajtimi terapeutik e rehabilitues i saj, përgjithësisht ka munguar. Kjo për shkak të tensioneve, acarimeve mes ankuesit dhe bashkëshortes, mos dakordësisë, refuzimit, mos bashkëpunimit për trajtimin e duhur dhe adekuat të fëmijës A. S.

Ky tension divorci mes bashkëshortëve është reflektuar në 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa për marrjen e masës së përkohshme në Gjykatën e Vlorës, në kallëzime e denoncime në Komisariat, në kërkesa për urdhëra mbrojtjeje, etj, por që fatkeqësisht kanë rënduar gjendjen e fëmijës A. S, në mosmarrjen e trajtimit të duhur terapeutik e rehabilitues.

Pasi PMF (Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve) Bashkia Vlorë, pas raportimit të rastit nga ankuesi, nuk e ka trajtuar çështjen në mënyrë emergjente e në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 18/2017 dhe aktet nënligjore përkatëse (fakt ky i konstatuar edhe nga ASHDMF, sipas monitorimit të bërë në datat 23 dhe 24 qershor 2025), ankuesi, me datë 03.12.2024 i është drejtuar ASHDMF-së, për ndërhyrje të menjëhershme lidhur me trajtimin shëndetësor të fëmijës A. S.

Në ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, që është baza e veprimtarisë dhe kompetencave të ASHDMF-së, ndër të tjera, gjenden parashikimet poshtëcituar dhe që lidhen dhe me rastin konkret:

Neni 1 “Objekti”

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Neni 2 “Qëllimi”

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;
- b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;
- c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;
- ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;
- d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;
- e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Neni 3 “Përkufizime”

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

....

2. “Autoritet përgjegjës” është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat, brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/jnë politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, kryen/jnë dhe mbulon/jnë shërbime të specializuara e profesionale për fëmijën.

....

3. “Dhunë ndaj fëmijës” është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. “Fëmijë i pashoqëruar” është fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji.

6. “Fëmijë në nevojë për mbrojtje” është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

....

8. “Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

....

10. “Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

Neni 5 “Parime të përgjithshme”

Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.
2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
3. Barazia dhe mosdiskriminimi.
4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t’i krijuar kushtet e jetesës, për t’i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
5. Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj.
8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.
9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

Neni 6 “Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës”

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.
2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.
3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:
 - a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;
 - b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
 - c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
 - ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
 - d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Neni 7 “E drejta e jetës”

1. Mbrojtja e jetës së fëmijës është e garantuar me ligj. Fëmija gëzon standardet më të larta të mundshme të shëndetit, trajtimit e rehabilitimit.
2. E drejta e aksesit të fëmijës tek institucionet e kujdesit shëndetësor garantohet pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, racës, etnisë dhe aftësisë ose situatës ekonomike, sociale e ligjore të prindërve apo kujdestarit.
3. Çdo fëmijë që ka nevojë për shërbim shëndetësor ose trajtim mjekësor apo rehabilitues.

Neni 9 “E drejta për të qëndruar me prindërit”

...

3. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.
4. Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës

Neni 21 “E drejta për kujdes shëndetësor”

...

4. Prindërit kanë detyrimin të kërkojnë kujdes mjekësor, me qëllim që fëmija të gëzojë standardin më të lartë shëndetësor, si dhe për të parandaluar situata që mund të jenë të rrezikshme për jetën, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 23 “Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës”

1. Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Fëmija mbrohet edhe nga të gjitha format e migracionit të paligjshëm, sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

2. Prindërit e fëmijës ose kujdestari, në bashkëpunim me institucionet e kujdesit shëndetësor, të edukimit, strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik e emocional, si dhe integrimin social të fëmijës viktimë e dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit ose abuzimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 30 “Ushtrimi i kujdesit prindëror”

1. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t’i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.

2. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezultojnë se qëndrimi i mëtëjshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe në këtë ligj.

3. Prindërit e fëmijës, pavarësisht faktit se cili prej tyre ushtron përgjegjësinë prindërore, kanë të drejtë të marrin informacion dhe asistencën e nevojshme për mirërritjen, kujdesin dhe edukimin e fëmijës, të marrin informacion për fëmijën nga shkolla, njësitë e shërbimit shëndetësor ose çdo institucion tjetër në kontakt me fëmijën.

4. Në rast se të dy prindërit ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, por nuk bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, vendimet lidhur me zgjedhjen e edukimit ose trajnimit profesional, trajtimet mjekësore komplekse ose ndërhyrjet kirurgjikale, vendbanimin e fëmijës ose administrimin e pasurisë së tij, merren me pëlqimin e të dy prindërve.

Neni 32 “Fëmija me aftësi të kufizuar”

1. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.
 2. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfutur nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit.
 3. Prindi ose kujdestari ka detyrimin të ndjekë procedurat e detyrueshme, sipas këtij ligji, për t'i siguruar fëmijës aksesin në të gjitha shërbimet nga të cilat përfiton sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, prindi ose kujdestari asistohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve sipas nevojës.
 4. Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t'i ofrohet shërbimi edukativ, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme nga ajo ku jeton dhe që përmbush kriteret për këtë qëllim.
- Shpenzimet, në këtë rast, mbulohen nga buxheti i të dyja njësive të qeverisjes vendore. Rregullat dhe procedurat për mbulimin e këtyre shpenzimeve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.
5. Autoritetet përgjegjëse, sipas këtij ligji, eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive, që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 34 “Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

1. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.
2. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë:
 - a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror;
 - b) grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor.
3. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror janë:
 - a) ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;
 - b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
 - c) çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.
4. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:
 - a) bashkia;
 - b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
 - c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
 - ç) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative;

d) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

5. Mekanizmat dhe strukturat në nivel qendror e vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit e të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këta mekanizma dhe struktura bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 40 “Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është person juridik në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, financuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe burime të tjera, sipas ligjit.

.....

4. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e agjencisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 41 “Detyra e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me ngritjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës”

1. Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për paranda

limin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

2. Agjencia ka për detyrë t’u ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me:

a) koordinimin me agjenci të tjera shtetërore dhe private;

b) zhvillimin e aktiviteteve profesionale, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës;

c) asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si edhe supervizimin, në raste të caktuara; bashkërendim të punës për raste ndërshtetërore të mbrojtjes së fëmijës;

ç) këshillimin e agjencive shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të punonjësve që punojnë në institucione publike e private për ndihmën e fëmijës në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, për të cilën agjencia nxjerr një urdhër të brendshëm për mënyrën e funksionimit.

3. Agjencia ka për detyrë gjithashtu:

a) të mbledhë të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe të menaxhojë regjistrin elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje;

- b) të analizojë nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë të parandalimi;
- c) të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes;
- ç) të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje;

Neni 44 “Mbështetja e agjencisë nga autoritetet shtetërore”

Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me agjencinë, për realizimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave të nevojshme, në kuadër të ngritjes dhe zbatimit të standardeve për një sistem funksional të integruar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të dhënave të tjera, të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

Neni 69 “Kundërvajtjet administrative”

1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 32 e 33, të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

- a) personi fizik, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- b) personi juridik, nga 60 000 deri në 100 000 lekë;
- c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 60 000 deri në 80 000 lekë.

2. Çdo mospërbushje e detyrimeve ligjore nga strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës konsiderohet kundërvajtje administrative, sipas neneve 38, 39, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 57, 59, 60, 62, 64, 65, 66 e 67 të këtij ligji.

3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organi, i cili konstaton kundërvajtjen administrative, vendos dhe ekzekuton sanksionet administrative.

4. Vendimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është titull ekzekutiv. Procedura për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimin e gjobave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

5. Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

“Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të ASHDMF-së⁸”, në pikën 2/d⁹, të saj, parashikon se, *Agjencia ka përgjegjësi në lidhje me kontrollin e zbatimit të ligjit dhe vendosjen e sanksioneve administrative: monitoron zbatimin e ligjit dhe fillon procedurën e kryerjes së kontrollit kur dyshon*

⁸ Miratuar me VKM nr. 635, datë 25.09.2019 “Për rregullat e organizimit dhe funksionimit të ASHDMF-së”.

⁹ Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë.

ose konstaton shkelje të ligjit, si dhe vendos sanksione për shkeljen e të drejtave të fëmijës dhe mospërbushjen e detyrimeve ligjore nga strukturat dhe punonjësit e përcaktuar për mbrojtjen e fëmijës, të sanksionuar sipas legjislacionit në fuqi.

Nga tërësia e normave të mësipërme konstatohet se ASHDMF, ka një pozicion qendror në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Përtej rolit koordinues për organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve, Agjencia, ka për detyrë t'u ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, në lidhje me asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen për raste të caktuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si dhe të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes së tyre.

Qartazi konstatohet se, strukturat për mbrojtjen e fëmijëve pranë Bashkisë Vlorë, për rastin konkret, janë treguar jo efëcente, neglizhente e burokratike në trajtimin e ankesës së subjektit ankues, në lidhje me ndërhyrjen emergjente për trajtimin e fëmijës A. S.

Komisioneri konstaton se, edhe ASHDMF, megjithëse është vënë në dijeni të situatës komplekse të rastit që në fillim të dhjetorit të vitit 2024, me kërkesë të ankuesit, ka zvarritur me një procedurë 7 (shtatë) mujore shkresash, kthim përgjigjesh, informacionesh me Drejtorinë e Shërbimit Social Vlorë, kryesisht lidhur me takimet e ankuesit me vajzën A. S (sipas procesverbalëve përkatës) duke anashkaluar problemin më imediat e thelbësor të pasqyruar në dokumentacion, rekomandime mjekësore, vendime të gjykatave, për ndërhyrjen e menjëhershme për terapi përkatëse e të specializuar të fëmijës A. S, me çrregullime të spektrit autik.

Sigurisht ndihmën dhe ndërhyrjen imediate për të garantuar trajtimin shëndetësor përkatës të fëmijës A. S, duhet ta jepte struktura përkatëse pranë Bashkisë Vlorë, por, në mungesë të efëcencës dhe përbushjes së detyrës ligjore nga kjo e fundit, ASHDMF, me t'u vënë në dijeni të rastit, duhet të ndërhynte shpejt e pa vonesë në garantimin e trajtimit të duhur shëndetësor të së miturës A. S, duke evidentuar e marrë masat përkatëse për përbushjen e tij, si dhe duke marrë masat respektive kundrejt personave përgjegjës pranë strukturës së mbrojtjes së fëmijëve, pranë Bashkisë Vlorë, të cilët me mosveprimin e neglizhencën e tyre kanë penguar realizimin e sa më sipër.

Megjithëse që nga data 28.10.2022, QKTRF, ka rekomanduar që fëmija A.S, të ndjekë:

- Terapi Zhvillimi;
- Logopedi;
- Ndjekje e rregullt e kopshtit në prani të një mësueseje ndihmëse;

dhe në vijimësi me akte të tjera, ka rekomanduar rikontrolle e ndjekje periodike të rastit, që përgjithësisht nuk janë realizuar për shkak të mungesës së bashkëpunimit të nënës së fëmijës A. S dhe mos shfrytëzimit të mekanizmave të duhur ligjorë nga strukturat përkatëse të mbrojtjes së fëmijëve pranë Bashkisë Vlorë, e për rrjedhojë është kërkuar ndërhyrja e ASHDMF-së.

Por, sa më sipër, rezulton që kjo e fundit, përveç 4 (katër) shkresave drejtuar strukturave të mbrojtjes së fëmijëve pranë Bashkisë Vlorë, e përcjelljes së informacionit përkatës për ankuesin,

Avokatin e Popullit apo KMD-në, nuk ka qenë reaguese në kohë dhe efektive në veprimet e saj në mbrojtje të drejtës për trajtimin shëndetësor të fëmijës së mitur A. S.

Në shkresat e ASHDMF-së: me nr. 19935/1 prot., datë 30.12.2024, e-mailin e datës 08.01.2025, shkresën nr. 22/18, datë 25.05.2025, si dhe në akt-kontrollin e kryer në datat 23 dhe 24 qershor 2025, është konstatuar mangësi dhe zvarritje e paarsyeshme lidhur me monitorimin, evidentimin e trajtimin e rastit të fëmijës A. S, nga PMF/Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Sociale/Bashkia Vlorë.

Sipas ligjit nr. 18/2017, nenit 69, të tij dhe Rregullores së ASHDMF-së, kjo e fundit ngarkohet me kontrollin e zbatimit të ligjit dhe vendosjen e sanksioneve administrative.

Shkelja e të drejtave dhe mospërbushja e detyrimeve ligjore, sipas nenit sipërcituar, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nga personi fizik, personi juridik, personi fizik brenda personit juridik, personi që ushtron funksion publik, strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe është detyrë e ASHDMF-së, konstatimi, vendosja e sanksionit administrativ.

Me shkresën nr. K5/R, 5-1 prot., datë 05.03.2025, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, pranë Avokatit të Popullit, pas njohjes me ankesën e shtetasit R. S lidhur kryesisht me problematikat për trajtimin shëndetësor të vajzës A. S, me spektër autik, i është vënë në dukje ASHDMF-se, se:

“Neni 51, i ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcakton se punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, duhet të identifikojnë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, të komunikojnë me profesionistë nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët, të bëjnë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje, të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë, me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel qendror dhe vendor, si dhe me shoqërinë civile.

E rëndësishme është që, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashkinë Vlorë, për rastin në fjalë, të marrë një rol proaktiv për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet prindërve, në interesin më të lartë të vajzës së tyre me aftësi të kufizuara.”

Më tej, Avokati i Popullit i sjell në vëmendje:

“Ndërkohë që neni 62/3, i ligjit nr. 18/2017, përcakton se: “Prindi, personi ligjërisht përgjegjës, qoftë person fizik apo person juridik, ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe t’u ofrojë atyre informacionin e nevojshëm për adresimin e situatës apo rastit, në rast se personat e mësipërm refuzojnë të bashkëpunojnë apo ndalojnë strukturat e mbrojtjes së fëmijës

të bëjnë verifikimet e nevojshme, atëherë verifikimi bëhet forcërisht, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit.

Mosbashkëpunimi apo ndalimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijës për verifikim, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.”

Në përfundim, Avokati i Popullit kërkon informacion lidhur me rastin në fjalë, në përputhje me detyrat e ASHDMF-së, sa i përket ngritjes dhe mirëfunksionimit të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në interesin më të lartë të fëmijës me AK.

Komisioneri vëren se, për shkak se NJMF, pranë Bashkisë Vlorë ka dështuar në trajtimin e rastit të fëmijës A. S, në përputhje me ligjin e aktet nënligjore përkatëse, atëherë është dashur një reagim më i shpejtë, operacional në konstatimin, evidentimin, ndëshkimin administrativ të personave fizik apo strukturave përgjegjëse vendore, në neglizhimin për trajtimin efektiv të fëmijës së mitur A. S, me terapi për spektrin autik, me përfshirjen e të dy prindërve.

Vetëm pas 7 (shtatë) muajve nga ankesa e z. R. S, ASHDMF, ka realizuar një kontroll specifik për rastin në fjalë, duke lënë një sërë rekomandimesh, për strukturat e mbrojtjes së fëmijës, pranë Bashkisë Vlorë.

Qartazi nga ky akt kontroll dhe rekomandimet përkatëse, dalin në pah, të metat e theksuara, mungesa e profesionalizmit të Strukturës të Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë Bashkisë Vlorë, në trajtimin e rastit të fëmijës së mitur A. S, me spektër autik.

Gjithashtu fakti se ankuesi ka qenë në proces zgjidhje martese (prej vitit 2022) me bashkëshorten e tij, si dhe lënien e fëmijëve të mitur A. S dhe A. S për rritje dhe edukim, nuk përjashton ASHDMF-në, si dhe nuk krijon konflikt juridiksional me gjyqësorin e as i mbivendoset këtij të fundit. Përkundrazi, aktet e ASHDMF-së dhe strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës, duke qenë institucion e struktura të specializuara, që merren vetëm me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, i shërbejnë Gjykatës, krahas provave të tjera për një vendimmarrje të drejtë e të bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Qenia e çështjes edhe në proces gjyqësor, ku është trajtuar në vijimësi edhe problemi i trajtimit me terapinë përkatëse të fëmijës A. S, duhej t'i kishte shërbyer ASHDMF-së, për një ndërhyrje të menjëhershme, të drejtpërdrejtë, konkrete dhe efektive, për vënien në lëvizje të mekanizmave ligjor, institucional e ndërinstitutional, në lidhje me garantimin e trajtimit të duhur terapeutik e psiko-emocional të fëmijës A. S.

Pra, kjo ndërhyrje e ASHDMF-së (kontrolli dhe rekomandimet përkatëse), është e vonuar në kohë, për këto shkaqe:

- a) është vënë në dijeni që në fillim të dhjetorit 2024, për kompleksitetin e çështjes;
- b) në ndryshim nga personat e sëmurë, për të cilët përgjithësisht ka një afat kohor për trajtimin e tyre me medikamente, për fëmijët autik, kërkohet një program individual i vazhdueshëm dhe

i rikontrollueshëm, për trajtimin e tyre të specializuar me logoped, mësues ndihmës si dhe mjekë të tjerë sipas nevojave dhe vlerësimit të rastit.

Fakti që ASHDMF, referuar rastit konkret të fëmijës A. S, ka dalë me 9 (nëntë) rekomandime për strukturat e mbrojtjes së fëmijës në Bashkinë Vlorë, ku 8 (tetë) prej tyre përcaktohen si niveli i rëndësisë së lartë, dhe nga ana tjetër, caktimi i periudhave të zbatimit të secilit rekomandim ku përgjithsisht është 6 (gjashtë) muaj, bie ndesh me emergjencën e rastit dhe lë shteg për zvarritje të mëtejshme në zbatimin rigoroz të ligjit dhe parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, *dosja e individualizuar për fëmijën A. S, rivlerësimi i thelluar i rastit dhe intervistimi i dy prindërve*, duke caktuar afat zbatimi 6 muaj, është zvarritje e procesit, kur, një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit dhe problematikës është ekspozuar si pranë PMF/Bashkia Vlorë, ashtu dhe ASHDMF-së.

Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Vlorë, në rastin e fëmijës A. S, ka pasur vonesa të tejzgjatura në përcjelljen e informacionit të kërkuar nga ASHDMF, ndaj kjo e fundit ka rekomanduar përcjelljen e informacionit nga Bashkia Vlorë brenda afatit 10 (dhjetë) ditor. Koha e zbatimit për këtë rekomandimin është lënë 2 (dy) muaj.

Lënia e këtij afati zbatimi është krejtësisht e pakuptimtë dhe e paarsyeshme. Zbatimi i këtij rekomandimi duhet të jetë i menjëhershëm. Zbatimi i ligjit për kërkesat për informacion dhe firmosja e shkresave nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, duhet të jenë konfrom respektimit të afatit ligjor 10 (dhjetë) ditor, si ndaj ASHDMF-së, ashtu dhe ndaj çdo institucioni tjetër apo individ.

Komisioneri vlerëson se, lënia e afateve të zbatimit të rekomandimit, duhet të jetë në periudha të arsyeshme kohore, në përputhje me nevojat dhe urgjencën e rastit.

ASHDMF, ka kryer në Bashkinë Vlorë, jo një kontroll të përgjithshëm rutinor e të planifikuar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, por, ka kryer një kontroll specifik vetëm për rastin e fëmijës A. S, e cila siç rezulton nga aktet, që nga viti 2022 e në vijim, nuk rezulton të ketë marrë një trajtim individual shëndetësor e të vazhdueshëm për spektrin autik, për shkaqet e shtjelluara në këtë vendim.

Ndaj, megjithëse niveli i rëndësisë së rekomandimeve është vlerësuar i lartë, nga vetë ASHDMF, koha e zbatimit të tyre nga DNSHS/Bashkia Vlorë, në afatet 6 (gjashtë) mujore, nuk i përgjigjet rëndësisë, emergjencës dhe efektivitetit në trajtimin e rastit.

Pra, në qëndrimin e ASHDMF-së, ka një kontradiktë, ku, megjithëse shumica e rekomandimeve përcaktohen të nivelit të rëndësisë së lartë, nga ana tjetër përcaktohen afate kohore gjashtë mujore (relativisht të gjata, për rastin konkret, për shkak të specifikave e nevojave të veçanta të fëmijës të mitur A. S).

Mosndjekja e terapisë dhe programeve përkatëse nga fëmijët me autizëm, në mënyrë të rregullt, periodike e konstante, përbën regres në zhvillimin e tyre.

Në Metodologjinë e Kontrollit të Cilësisë së Punës të Strukturave të Mbrojtjes së Fëmijëve, në nivel vendor, të miratuar me Udhëzimin nr. 767, datë 28.12.2023, të MSHMS, është përcaktuar:

Detyrat dhe përgjegjësitë e ASHDMF:

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), ka detyrimin ligjor kontrollin e cilësisë së punës të strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor. Ky detyrim përfshin mbështetjen e Agjencisë nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, për realizimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave të nevojshme, në kuadër të ngritjes dhe zbatimit të standardeve për një sistem funksional të integruar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të dhënave të tjera, të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

Në kuadër të kontrollit të cilësisë së punës së strukturave përgjegjëse për shërbimet shoqërore në 61 bashki të vendit, ky detyrim ligjor përfshin kontrollin e zbatimit:

- të procedurave të menaxhimit të rasteve për fëmijët në nevojë për mbrojtje;
- të funksionimit të bashkëpunimit ndërsektorial (në kuadër të Grupeve Teknike Ndërsektoriale) dhe të qasjes multidisiplinare gjatë procesit të menaxhimit të rasteve për fëmijët në nevojë për mbrojtje;
- të ndërveprimit me familjen e fëmijës për shqyrtimin dhe vendimet që lidhen me fëmijën në nevojë për mbrojtje;
- të dokumentimit rigoroz dhe administrimit të të dhënave të çdo rasti, në përputhje me kriteret ligjore

Pas analizimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, Komisioneri i vlerëson të bazuara pretendimet e ankuesit R. S, se:

- Tetë muaj më pas, ende asnjë përgjigje thelbësore për terapistë jetike Pavarësisht se rasti i vajzës A.S. është referuar pranë ASHDMF që më datë 03.12.2024, dhe, përkundër detyrimit ligjor për të ndërmarrë masa të menjëhershme dhe efektive, kjo Agjenci:
- ende nuk ka konfirmuar nëse fëmija ndjek ndonjë formë terapie zhvillimore apo mbështetjeje profesionale;
- nuk ka hartuar ose zbatuar një Plan Individual të Mbrojtjes (PIM), i cili është instrument themelor sipas ligjit nr. 18/2017;
- nuk ka garantuar ofrimin e shërbimeve rehabilituese dhe terapeutike të nevojshme për një fëmijë me çrregullim të spektrit autik;
- nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për të siguruar ndihmë psiko-sociale, logopedike apo zhvillimore, pavarësisht kohës së gjatë të kaluar dhe kërkesave të përsëritura të prindit ankues.

Ligji nr. 18/2017, parashikon qartë se ndërhyrja e hershme dhe e menjëhershme është parim themelor i sistemit të mbrojtjes.

Përfundimisht Komisioneri vlerëson se, ASHDMF, ka pasur në dispozicion të gjitha mjetet ligjore për monitorimin e ligjit për rastin konkret, duke kryer procedurën e kontrollit dhe vendosjen e sanksioneve për shkeljen e të drejtave të fëmijës A. S, por është mjaftuar me akte përgjithsisht formale dhe me një akt kontroll të vonuar, gjë e cila nuk ka siguruar interesin më të lartë të fëmijës, i cili është trajtimi i duhur shëndetësor, me terapi individuale për A. S, me spektër autik.

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se fëmija A. S i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e ASHDMF-së, për shkak të AK.

B. Shkaku i mbrojtur – Aftësia e kufizuar

Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Subjekti ankues, ka pretenduar diskriminim të vajzës për shkak të *“aftësisë së kufizuar”* të saj.

Bazuar në dokumentin me të dhënat mjekësore të fëmijës A. S, të mjekes specialiste¹⁰ pranë Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët (QKTRF), lëshuar me datë 28.10.2022 dhe me numër regjistri 1051, rezulton që ajo është diagnostikuar me: *“S. Çrregullim i Spektrit të Autizmit”*.

Referuar këtij dokumenti, mjeku specialist rekomandon për fëmijën A. S, të moshës 4 (katër) vjeç:

- Terapi Zhvillimi;
- Logopedi;
- Ndjekje e rregullt e kopshtit në prani të një mësueseje ndihmëse.

Diagnoza¹¹ e mësipërme e fëmijës A. S është e njohur nga ana e ASHDMF-së, subjekt ndaj së cilit është paraqitur dhe ankesa e prindit të fëmijës.

¹⁰ Dr. B. Z, Psikiatre e Fëmijëve dhe Adoloshentëve

¹¹ Përcaktuar si “S. Çrregullim i Spektrit të Autizmit”.

Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara¹²”, në nenin 1 të saj, ka përcaktuar se: *“Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët”*.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga subjekti ankues konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se vajza e tij e mitur, e mbart atë. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar e dokumentuar shkakun e pretenduar të diskriminimit nga pala ankuese, atë të *aftësisë së kufizuar*.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm të fëmijës A. S nga ana e ASHDMF-së, me shkakun e mbrojtur, “aftësinë e kufizuar”.

Shqipëria i përmbush instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e saj ligjor në përputhje me standardet evropiane. Brenda këtij konteksti, Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor dhe nënligjor të përparuar që adreson çështjet e pronësisë bazuar në standartet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021)

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlijet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë

¹² Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012.

(Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese).

Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 17, i Kushtetutës, përcakton se: “Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 16/1, i Kushtetutës së Shqipërisë, sanksionon se, të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.

Neni 54/1, i Kushtetutës, sanksionon se, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

Në nenin 59, shkronjën f) të saj, Kushtetuta ka parashikuar se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:...f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve¹³, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë

¹³ Term i papërshtatshëm ky, por që i referohet personave me aftësi të kufizuar.

së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹⁴.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

- “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...*
- 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...*

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*

¹⁴ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në nenin 14 të saj, ndalon çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtave të garantuara nga Konventa, përfshirë të drejtën për trajtim efektiv shëndetësor.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁵. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹⁶. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁷. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹⁸.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 25, të saj përcakton se:

“1. Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

2. Nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.”

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹⁹ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë

¹⁵ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹⁶ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁷ Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁸ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

¹⁹ Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Aftësia e kufizuar gëzon mbrojtje nga KEDNJ dhe shtetet që e kanë ratifikuar atë, kanë detyrimin pozitiv të mbrojnë fëmijët nga diskriminimi për këtë shkak.

Në këtë kontekst, Shqipëria në cilësinë e shtetit palë në Konventën e sipërpërmendur²⁰, në kuadër të plotësimit të të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej saj, duhet të përmbushë edhe detyrimin për kujdes mjekësor për personat me aftësi të kufizuara.

Sipas përcaktimit në Kushtetutën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, *shëndeti*, është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore dhe jo thjesht mungesa e sëmundjes.²¹ E drejta për shëndet është një e drejtë themelore e njeriut, e cila parashikohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe një sërë traktatesh të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, në të cilat vendi ynë është pjesë. E drejta për shëndet, nuk është një e drejtë absolute për të patur një shëndet të mirë, por e drejta për të pasur një gjendje sa më të mirë shëndetësore, fizike e mendore²². Rrjedhimisht e drejta për shëndet, duhet të kuptohet si e drejta për të gëzuar një sërë lehtësish, të mira dhe shërbime, të cilat janë të nevojshme për të patur standartin më të lartë të arritshëm të shëndetit.²³ Ndër të tjera, e *drejta për shëndet përfshin*²⁴:

- Të drejtën për një sistem të kujdesit shëndetësor, që siguron barazi e mundësi, që secili të gëzojë nivelin më të lartë të arritshëm të shëndetit;
- Të drejtën për parandalim, trajtim dhe kontroll të sëmundjeve...”

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin Nr.14/2000 “*E drejta për standartin më të lartë të arritshëm të shëndetit*”, ka sqaruar se, të gjitha lehtësitë, të mirat dhe shërbimet, duhet të jenë të disponueshme, të aksesueshme, të pranueshme dhe me cilësi të mirë.

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, gjithashtu ka theksuar se, shtetet kanë një detyrim minimal bazë, për të siguruar përmbushjen e niveleve minimale thelbësore, të secilës prej të drejtave sipas Paktit. Ndërsa këto nivele thelbësore janë deri diku të varura nga burimet, atyre duhet t'u jepet përparësi nga Shteti, në përpjekjet e tij për të realizuar të drejtat sipas Paktit. Në lidhje me të drejtën për shëndet, Komiteti ka nënvizuar se shtetet duhet të sigurojnë, ndër të

²⁰Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e OKB-së, “Për për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” nëpërmjet Ligjit nr. 108/2012 datë 15.11.2012.

²¹ Fact Sheet 31 “*E Drejta për Shëndet*”, publikuar nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut, të Kombeve të Bashkuara dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

²² Referenca si më sipër.

²³ Komenti i Përgjithshëm nr.14/2000 “*E drejta për standartin më të lartë të arritshëm të shëndetit*”, miratuar nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”.

²⁴ Fact Sheet 31 “*E Drejta për Shëndet*”, publikuar nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut, të Kombeve të Bashkuara dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

tjera: të drejtën për akses në lehtësitë, të mira dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor, në baza jodiskriminuese, veçanërisht për grupët vulnerabël ose të marginalizuar²⁵...

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, e interpreton të drejtën e fëmijëve për shëndet, siç përcaktohet në nenin 24, të Konventës “Për të Drejtat e Fëmijës”, *si një e drejtë gjithëpërfshirëse, e cila shtrihet jo vetëm në shërbimet e duhura dhe në kohën e duhur, në lidhje me parandalimin, promovimin, shërbimet kurative, rehabilituese dhe paliative, por edhe në të drejtën për t’u rritur dhe zhvilluar potencialin e tyre të plotë dhe të jetojnë në kushte që u mundësojnë atyre të arrijnë standardin më të lartë të shëndetit përmes zbatimit të programeve që adresojnë elementët thelbërorë përcaktues të të drejtës për shëndet.*

E drejta e fëmijëve për të patur standartin më të lartë të arritshëm për shëndetin e tyre, vendos mbi autoritetet shëndetësore detyrimin për të siguruar që asnjë fëmijë të mos i mohohen shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe barnat thelbësore të nevojshme për trajtimin shëndetësor.

Referuar Fact Sheet 31 “*E Drejta për Shëndet*”, e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, të Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë, citohet se:

“E drejta për shëndet përfshin edhe drejtat e mëposhtëme:

- *Të drejtën për një sistem të kujdesit shëndetësor, që siguron barazi e mundësi, që secili të gëzojë nivelin më të lartë të arritshëm të shëndetit;*
- *Të drejtën për parandalim, trajtim dhe kontroll të sëmundjeve;*
- *Garantim të medikamenteve të domosdoshme;”*

Në dokumentin e mësipërm citohet gjithashtu: “*Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ka theksuar gjithashtu se shtetet kanë detyrimin minimal thelbësor, për të siguruar përmbushjen e niveleve minimale thelbësore të secilës prej të drejtave të parashikuara në Konventë. Ndonëse këto nivele thelbësore, deri diku, varen nga burimet, atyre duhet t’u jepet prioritet nga shteti në përpjekjet e tij për të realizuar të drejtat sipas Konventës....”*

Konventa për të Drejtat e Fëmijës ²⁶ është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës.

Disa nga të drejtat kryesore të fëmijëve, sipas Konventës, janë:

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim: të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta. Asnjë prej tyre nuk mund të diskriminohet për shkak gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale, si dhe për çdo shkak tjetër.

²⁵ Fact Sheet 31 “*E Drejta për Shëndet*”, publikuar nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut, të Kombeve të Bashkuara dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

²⁶ Kjo konventë u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

Interesi më i lartë i fëmijës: Të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën e të Drejtave të Fëmijës duhet t'u sigurojnë mbrojtjen dhe kujdesin për mirëqenien e nevojshme të gjithë fëmijëve. Ato angazhohen ta realizojnë këtë duke patur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tyre, kujdestarëve të tyre ligjorë dhe personave të tjerë ligjërisht përgjegjës duke marrë masat e nevojshme legjislative dhe administrative.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, (KEDNJ) parashikon si më poshtë citohet:

Neni 2

1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

Neni 3

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Neni 18

1. Shtetet Palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës.

2. Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, Shtetet Palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.

Neni 24

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfutur nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

....

b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin,.. Konventa “Mbi Marrëdhëniet me Fëmijët”²⁷, përcakton se:

Neni 1

“Objekt i kësaj Konvente janë:

a) përcaktimi i parimeve të përgjithshme për t'u zbatuar me lidhje në vendimet mbi marrëdhëniet;

b) rregullimi i garancive të përshtatshme për të siguruar ushtrimin e rregullt të marrëdhënieve dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në fund të afatit të marrëdhënies;

c) vendosja e bashkëpunimit ndërmjet organeve qendrore, organeve gjyqësore dhe organeve të tjera për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët.”

Neni 12 “Detyrat e organeve qendrore”

Organet qendrore të shteteve palë:

a) bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet organeve kompetente, duke përfshirë organet gjyqësore në vendet e tyre përkatëse për të arritur qëllimet e Konventës. Ata veprojnë me të gjithë shpejtësinë dhe efektivitetin e duhur;

b) me qëllim që të lehtësohet zbatimi i kësaj Konvente, pajisin, pas kërkesës përkatëse, njëri-tjetrin me informacion në lidhje me ligjet e brendshme që rregullojnë përgjegjësitë prindërore, duke përfshirë marrëdhëniet dhe me çdo informacion të detajuar në lidhje me mbrojtjen dhe garancitë përveç atyre të parashikuara sipas paragrafit 1 të nenit 10, dhe shërbimet e ofruara prej tyre (duke përfshirë shërbimet ligjore, të financuara me fonde publike ose të tjera), si dhe me informacione mbi çdo ndryshim në këto ligje dhe shërbime;

c) bëjnë të gjitha përpjekjet për të zbuluar vendndodhjen e fëmijës;

d) sigurojnë transmetimin e kërkesave për informacion që vijnë nga organet kompetente në lidhje me çështjet ligjore ose faktike mbi një gjykim të papërfunduar;

e) e mbajnë njëri-tjetrin të informuar për çdo vështirësi që mund të lindë gjatë zbatimit të Konventës dhe, nëse është e mundur, mënjanojnë pengesat për zbatimin e saj.

Konventa e Kombeve të Bashkuara “ Mbi të drejtat e fëmijës”, përcakton:

Neni 2/1.

²⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 9359, datë 24.03.2005 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane “Për Marrëdhëniet me Fëmijët””.

Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

Neni 24/1.

Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, në nenet 2 dhe 12, të tij, parashikon respektivisht:

“2/2. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të garantojnë që të drejtat e shpallura në këtë Pakt, të ushtrohen pa kurrfarë diskriminimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare a shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.

.....

12/1. Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për të pasur gjendje sa më të mirë shëndetësore, fizike e mendore që ai është i aftë të arrijë.”

Në bazë të garancive kushtetuese të ofruara nga nenet 18 dhe 54, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çdo fëmijë është i barabartë përpara ligjit, nuk mund të diskriminohet pa një përligje të arsyeshme dhe objektive dhe gëzon të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti.

Kodi i Familjes, parashikon se:

“Neni 2.

Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 3.

Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese.

Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.

Neni 215.

Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke

mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij”

Ligji nr. 18/2017 “*Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës*”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohen parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Ligji përcakton se: “...2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.”

Gjithashtu, në bazë të parimeve të vendosura nga ligji nr. 18/2017, përkatësisht në nenin 5, të tij, përmendet shprehimisht se fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërruar dhe progresive.

Në nenin 6, të të njëjtit ligj shtjellohet se, ndër të tjera autoritetet publike, siç është në rastin tonë ASHDMF, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijën, ku interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh ndër të tjera nevojat e fëmijës për zhvillim psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri dhe vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Në bazë të standardeve dhe parashikimeve ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve, të aplikueshme brenda sistemit juridik shqiptar, e drejta për trajtim të duhur dhe efikas shëndetësor dhe pa diskriminim e fëmijëve, përfshirë dhe fëmijët me aftësi të kufizuar, mbrohet në mënyrë të qartë.

Në nenin 3/1, të saj, sanksionohet se: “*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë në qendër të vëmendjes.*”

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur*

në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1, i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke pranuar që, në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara²⁸”.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t’i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ shprehet se: “... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarjen e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.²⁹”.

Një qasje e ngjashme gjendet në kuadrin e Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale të Këshillit të Evropës (*organi mbikëqyrës i Kartës Sociale Evropiane*), i cili gjithashtu u shpreh se ligji vendas, kombëtar duhet të sigurojë një lehtësim të barrës së provës në favor të paditësit në rastet e diskriminimit. Në të vërtetë, siç thuhet në Përmbledhjen e praktikës gjyqësore të Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale dhe gjithashtu thuhet nga GJEDNJ në çështjen në fjalë, barra e provës nuk duhet të jetë tërësisht mbi palën kërkuese dhe duhet të jetë objekt i një rregullimin e duhur në rast të diskriminimit.

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ndër të tjera thekson se: “...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga (viktima e diskriminimit) te (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë *prima facie* ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka

²⁸ GJEDNJ Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

²⁹ GJEDNJ Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se trajtimi nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese...”

Bazuar në nenin 82/2, të Kodit të Procedurave Administrative barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*

Në të njëjtën frymë është dhe ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1, të tij, ka përcaktuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë të kundërtën.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.³⁰

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

³⁰ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*³¹”.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues:

Së pari, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se pala ankuese (fëmija për të cilin dhe ankohet) i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e ASHDMF-së. Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë dhe i pafavorshëm i fëmijës së subjektit ankues, nga ana e ASHDMF-së, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Për sa më sipër, mbështetur në provat dhe faktet e administruara, KMD vlerësoi se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ana e ASHDMF-së, përmes mosveprimit efektiv dhe në kohën e duhur, kundërt fëmijës së subjektit ankues, dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Komisioneri vlerëson se, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (*diskriminimi prima facie*) se në pamje të parë fëmija i ankuesit është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar të saj, nga ana e ASHDMF-së, pasi rezultoi e provuar se, fëmija është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme lidhur me mosreagimin në kohë dhe me profesionalizëm të ASHDMF-së, pa një justifikim të arsyeshëm.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës³², Komisioneri vlerëson se fëmija A. S, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e ASHDMF-së,

Subjekti ankues ka pretenduar se fëmija i tij është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e ASHDMF-së. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi i provuar e dokumentuar fakti që fëmija i ankuesit e mbart shkakun e pretenduar, argumentuar në pjesën B, të Vendimit.

³¹ GJEDNJ, Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë (GC) paragrafi 147, (ECtHR, Nachova and others v. Bulgaria [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, Timishev kundër Rusisë (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, Timishev v. Russia (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, D.H. and others v. the Czech Republic [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

³² Shih Ndarjen III, nëndarja A.1, të vendimit të KMD.

Posedimi i shkakut të mbrojtur nga ana e fëmijës së subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pakundërshtuar nga ana e ASHDMF-së.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e ASHDMF-së, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar të fëmijës, nga subjekti ankues, dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të padrejtë nga ana e ASHDMF-së, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
- Që për veprimet dhe mosveprimet e ASHDMF-së, kundrejt fëmijës së ankuesit janë në përputhje me parashikimet ligjore, të drejta dhe të arsyeshme, si dhe që ai të ishte trajtuar në mënyrë të drejtë e të favorshme (analizuar në pjesën e II-të të Vendimit).

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykon se, ASHDMF, nuk arriti të provojë me dokumentacion, fakte apo prova të tjera që fëmija i ankuesit nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, lidhur me ndjekjen e vazhdimësinë e procedurave për monitorimin, kontrollin operativ dhe efektiv të strukturave përkatëse në Bashkinë Vlorë, duke vendosur dhe sanksione administrative, kjo në funksion të trajtimit të shpejtë e të qëndrueshëm të fëmijës së mitur me spektër të autizmit.

Komisioneri vlerëson gjithashtu se, ASHDMF, nuk ka arritur të provojë se sjellja e veprimeve saj në rastin konkret, janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar që garanton mbrojtje efektive dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në interesin më të lartë të tyre.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlojtë si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet marrja e shërbimeve, trajtimeve (përfshirë trajtimin e duhur shëndetësor, por jo vetëm) dhe lehtësirat e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025³³, citon ndër të tjera se:

“Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.

³³ Miratuar me VKM nr. 276, datë 12.05.2021

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026³⁴ (AKDF) është një dokument, i cili është hartuar në emër të Qeverisë Shqiptare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, si edhe në konsultim me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve. AKDF-ja është një angazhim për të përmbushur të drejtat e fëmijëve në Shqipëri me një kohështirje 2021–2026.

AKDF-ja drejtohet nga 4 parimet e përgjithshme të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), përkatësisht: mosdiskriminimi; interesi më i mirë i fëmijës; jeta, mbijetesa dhe zhvillimi; dhe pjesëmarrja.

Dokumenti citon ndër të tjera, se: *“Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF), e krijuar në vitin 2011, është organi ekzekutiv në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që ka përgjegjësinë e përgjithshme për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e AKDF-së. ASHDMF-ja është përgjegjëse për koordinimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve në përputhje me politikat kombëtare dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve.*

....

Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve, përfshin rritjen e fëmijëve në një mjedis mbështetës me praktika pozitive të prindërimit që i mbron nga dhuna dhe abuzimi. Ky qëllim ka në vëmendje funksionimin e një sistemi të dobishëm dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijës dhe fuqizimit të kapaciteteve të mekanizmave dhe shërbimeve për adresimin e dhunës ndaj fëmijëve. Ky qëllim ka prioritetizuar ngritjen dhe përmirësimin e mekanizmave dhe shërbimeve të veçanta dhe të integruara për adresimin e formave më të rënda të dhunës përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin online.”

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: *“...duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar³⁵ dhe se për shkak të cenueshmërisë së*

³⁴ Miratuar me VKM nr. 659, datë 03.11.2021

³⁵ Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar³⁶. ”

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm i fëmijës së subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, si dhe është tërësisht i papërligjur në fakte, prova e dispozita ligjore.

Gjithashtu, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka përcaktuar se diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar është i ndaluar sipas nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJEDNJ ka trajtuar raste ku ka konstatuar diskriminimin ndaj fëmijëve, për shkak të aftësisë së kufizuar të tyre. Diskriminimi i bazuar në aftësinë e kufizuar apo gjendjen shëndetësore është i mbrojtur nga KEDNJ, në të njëjtën mënyrë, si ai mbi bazën e karakteristikave të tjera personale, dhe GJEDNJ, thekson me forcë se, shteti ka detyrimin pozitiv për të parandaluar dhe sanksionuar aktet e diskriminimit, veçanërisht kur ato prekin fëmijët, e për më tepër ato famëjë që janë edhe me AK.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “ “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mosmarrja e trajtimit shëndetësor dhe me terapitë respektive, në kohën e duhur dhe në mënyrën e rekomanduar nga mjeku dhe specialistët e fushës, jo vetëm që përbën një rast diskriminimi të hapur, por gjithashtu cenon të drejtën e fëmijës së mitur me spektër të autizmit për shëndet dhe mirëqenie fizike e psikologjike, duke treguar se interesi më i lartë i fëmijës në këtë rast nuk është marrë në konsideratë dhe as nuk është parë me prioritet nga ASHDMF.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve e ka trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, fëmijën e mitur A. S, diagnostikuar me spektër autik, duke sjellë për pasojë diskriminimin dhe cenimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, përsa i takon neglizhencës, mondërhyrjes e marrjes së masave në mënyrë të menjëhershme, me efikasitet dhe në kohën e duhur, lidhur me trajtimin e rastit në fjalë.

36 Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se fëmija i subjektit ankues, A. S, në referencë të dispozitave të posaçme të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, është ekspozuar para veprimeve diskriminuese nga ana e ASHDMF-së.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*.

Ky ligj në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit ose parandalimin e situatave diskriminuese. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të fëmijës A. S, për shkak të aftësisë së kufizuar, diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik, nga ana e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Strukturave përkatëse të Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë Bashkisë Vlorë.
2. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, të marrë masa efektive duke monitoruar Strukturat përkatëse të Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë Bashkisë Vlorë, për të garantuar mbrojtjen e së drejtës së fëmijës A. S, për trajtimin terapeutik të specializuar dhe garantimin e mirëqenies e zhvillimit psiko-social të saj, duke përmbushur kërkesat e ligjit nr. 18/2017 *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*.

3. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për sa më sipër.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA